



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 584/117 Prot.

Tiranë, më 19.04.2021

VENDIM

Nr. 58, datë 19.04.2021

PËR

**PEZULLIMIN E ZBATIMIT TË VENDIMIT TË SENATIT AKADEMIK
NR.23, DATË 17.05.2019 “MBI PROPOZIMIN PËR DHËNIEN E
MBËSHTETJES FINANCIARE PËR PJESMARRJE NË KONFERENCA
BRENDA DHE JASHTË VENDIT”**

Në zbatim të nenit 38, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL e RSH”, të nenit 20 të Statutit të UST- së, si dhe Vendimeve të Senatit Akademik nr. 6 datë 22.01.2021 “Për ngritjen e Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve Shkencore” i ndryshuar me Vendimin nr. 31, datë 12.03.2021, Senati Akademik i UST-së në mbledhjen e datës 19.04.2021,

VENDOSI:

1. Të pezullojë zbatimin e Vendimit të Senatit Akademik nr. 23 datë 17.05.2019 “Mbi propozimin për dhënie e mbështetjes financiare për pjesmarrje në konferenca brenda dhe jashtë vendit”, deri në momentin e organizimit përfundimtar të Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë, Botimeve dhe Projekteve.
2. Ky vendim i jepet për zbatim Administratorit dhe i bëhet me dije njësisë kryesore.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AGRON KASA

